



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.122 dt.05.08.1997

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.05.08.1997, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndërtim Strehimit “Për privatizimin e objekteve të pa privatizuara ish pronë shtetërore”, në zbatim të ligjit Nr.7572, dt.10.05.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”

VENDOSI

1. Drejtoria e Ndërtim Strehimit të mos veprojë për procedurën e privatizimit të banesave akoma të pa privatizuara pa konfirmimin e prerë (pa mëdyshje) të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave ish – Pronarëve mbi pronësinë e truallit dhe të objektit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Ndërtim Strehimit.
3. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI